

Afloderm

Principi aktiv- Alclometasone 0.5mg/1g



Forma :Krem

Sasia:20 g

Farmakokinetika:

Në lëkurën e pa dëmtuar absorbimi sistematik i alclometazonit nuk kalon 3%. Dëmtimi i integritetit të lëkurës çon në një përthithje më të madhe të tij. Biotransformimi i tij më i madh bëhet në hepar në formën e metaboliteve të cilët eliminohen kryesisht me anë të urinës.

Farmakodinamika:

Alclometasoni ka veti antiinflamatore , immunosupresive dhe antiproliferative. Ul permeabilitetin dhe ndryshon ndërtimin membranor, redukton migrimin macrofageal dhe të limfociteve në qendër të inflamacionit duke ngadalësuar të gjitha fazat e inflamacionit, duke bllokuar lëshimin e qelizave yndyrore të ndjeshme dhe lëshimin e histaminës së bazofileve si dhe substancave të tjera aktive. Ul inflamacionin në inde dhe eliminon dhimbjet dhe mund të përdoret në lëkurë sensitive dhe në fytyrë.

Përdorimi :

1-2 lyerje në ditë sipas përshkrimit të mjekut

Indikacionet :

Dermatiti atopik, psoriasis ,urtikarie, sëmundje alergjike të lëkurës, në rastet e dermatozave në zonat e ndjeshme të lëkurës si fytyra.

Shtatzëni dhe laktacion

Nuk rekomandohet të përdoret në shtatzëni dhe në lëkurën e gjoksit gjatë laktacionit.

Kundër indikimet

Hipersensitiviteti, tuberkulozi i lëkurës, dermatitis perioral, rosacea, komplikimet e vaksinimit

Efektet anësore:

Efektet anësore janë të rralla dhe përfshijnë djegie, kruarje, skuqje, iritim dhe tharje të lëkurës. Akoma më rrallë mund të shfaqen folikuliti, atrofia e lëkurës dhe dermatitis i kontaktit sekondar si pasojë e infeksioneve të lëkurës.